



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:115734  
Datë: 03.05.2024  
Numri i dokumentit: 05697035

**C.nr.1168/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit - BKS me seli në Prishtinë, Rr. "Lidhja e Pejës", magj. Prishtinë-Fushë Kosovë, p.n, të cilin e përfaqëson kompania "Debt Loan Recovery SH.P.K", kundër të paditurit G.B. nga P., me bazë juridike rimbursim të dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 4340.00 euro, në seancën e datës 22.04.2024 mori ndërsa me datën 03.05.2024 përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSIDEROHET e tërhequr** padia e paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Lidhja e Pejës", magj. Prishtinë-Fushë Kosovë, p.n, kundër të paditurit G.B. nga P., e parashtruar me datë 16.09.2020, me bazë juridike rimbursim të dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 4340 euro.

**II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

**Arsyetim**

Në këtë gjykatë, paditësi Byroja Kosovare e Sigurimit - BKS me seli në Prishtinë, me datë 16.09.2020, ka parashtruar padi, kundër të paditurit G.B. nga P., baza juridike rimbursim të dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 4340.00 euro.

Gjykata, me datën 22.04.2024, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën seancë nuk ka prezantuar asnjëra nga palët ndërgjyqëse, respektivisht nuk ka prezantuar pala paditëse, e që nga shkresat e lëndës ka pasur prova se i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt, siç konstatohet nga fletëkthesa e kthyer gjykatës, ku i njëjti ftesën për seancën e ka pranuar me datën 27.03.2024, përkatësisht i autorizuari i tij), konform dispozitave ligjore të LPK-së, por që në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Në seancë nuk ka prezantuar as i padituri.

Sipas nenit 423 par.3 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se *"Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht,*

*konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit.”. Prandaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe nga arsyet e lartcekurat rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.*

Gjykata në bazë të nenit 423 par.3, 142 e lidhur me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.1168/20, me datë 22.04.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjete (15) ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.